



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dostiguar Prilbena / Pristalo Received / Dostiguv	12.01.24	4	
Organ / Agjencia Organi / Agencija Org / Agency	Dr. Prof. Dr. Prof. Prof. Dr.	Shkup e Puneg Appendix	Emri Emri i Drejtorit
SKIMSHICK	246/2024		1/3



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1404/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë dhe Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1404/2023 të datës 10.11.2023 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokat \_\_\_\_\_ kundër organit të punësimit Komuna e Lipjanit, në çështjen juridike “Kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.01.2024, mori këtë:

### V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet *jo kompetent* për të vendosur për ankesën me numër A.nr.1404/2023 të datës 10.11.2023 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_

### A r s y e t i m

Ankuesi, \_\_\_\_\_ në datë 10.11.2023 përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar Avokat \_\_\_\_\_ ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 6962/2023 të regjistruar nën shenjen A.nr.1421/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër organit të punësimit Komuna e Lipjanit, duke kërkuar rimbursimin e mjeteve në emër të diferencës së koeficientit 2 në kategorinë Specialistë, për periudhën kohore prej muajit Shkurt 2023 deri në muajin Maj 2023, gjatë kohës kur ka qenë në marrëdhënie pune në pozitën, Menaxher i Projekteve në Drejtorin për Shërbime Publike/Sektori për Menaxhim të Projekteve në kuadër të Komunës së Lipjanit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 29.11.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Komunën e Lipjanit. Ndërsa Këshilli me datë 30.11.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër reference 01-120/02-65999 së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me shifër: VK/2023 të datës 26.12.2023 ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.1404/2023 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 6962/2023 të parashtruar nga ankuesi përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar avokat \_\_\_\_\_ më datë 10.11.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë me numër 1-120/02-57157 të datës 06.11.2023; Ankesën e parashtruar nga ankuesi përmes përfaqësuesit të autorizuar avokat \_\_\_\_\_ në Komisionin e Ankesave në Komunën e Lipjanit; Kërkesën për rimbursim të datës 05.10.2023; Vendimin për transferim të përhershëm në vend tjetër të punës me Nr.1-400-46353/1 të datës 15.07.2019; Akt Emërimin të datës 01.05.2023; Autorizimin e datës 01.11.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 29.11.2023; Përgjigjen në ankesë me numër reference 01-120/02-65999 të datës 30.11.2023; Kërkesën e datës 03.08.2023; Propozimin e Komunës së Lipjanit për korigjimin e koeficientëve të datës 31.05.2023; Listën e pagave për muajin qershor 2023; Vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me Nr. 1-118/02-39970 të datës 02.08.2023; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 09.10.2012; Akt Emërimin të datës 21.02.2022; Kërkesën me numër 1-120/04-40970 të datës 07.08.2023; Listën e pagave për muajin korrik 2023; Vendimin e datës 26.12.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit ka analizuar provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe ka konstatuar se ankuesi, më datë 07.08.2023 dhe 05.10.2023 ka parashtruar kërkesë në Komunën e Lipjanit, duke kërkuar kompensimin-rimburesimin e mjeteve në emër të diferencës së koeficientit sipas Ligjit të ri nga niveli Profesional 2 në kategorinë Specialistë për periudhën kohore nga muaji shkurt deri në muajin maj të vitit 2023. Ndërsa Udhëheqësja e Personelit në Komunën e Lipjanit më datë 23.10.2023 i është përgjigjur ankuesit në kërkesën me numër reference 1-120/01-57157, me arsyetimin se me Vendimin me numër Nr.1-118/02-39970 të datës 01.08.2023 ju është ndërpre marrëdhënia e punës në Komunën e Lipjanit me ofrimin e Dorëheqjes me shkrim nga ju me datë 28.07.2023 andaj, kompensimi nuk mund të bëhet sepse ju nuk jeni më nëpunës i administratës komunale të Lipjanit

Po ashtu, Komuna e Lipjanit më datë 30.11.2023 përmes përgjigjes me numër reference 01-120/02-65999 ka njoftuar Këshillin se ankuesi është larguar nga Lista e pagave nga muaji gusht, meqenëse të njëjtit i është ndërpre marrëdhënia e punës më datë 01.08.2023 me ofrimin e Dorëheqjes me shkrim të datës 28.07.2023 dhe për këtë arsye i njëjti është larguar nga lista e pagave nga muaji gusht, ndërsa ankuesi kërkesën e ka parashtruar më datë 07.08.2023 dhe 05.10.2023 në kohën kur i njëjti është larguar nga lista e pagave në Administratën Komunale të Lipjanit, dhe për këtë arsye nuk mund të realizohet kompensimi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit ka analizuar Vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me numër 1-118/02-399970 të datës 02.08.2023 dhe ka konstatuar se sipas Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e

Përgjithshme Administrative përkatësisht nenit 144 paragrafi 1 ,, 1.Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.1. skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar; 1.2. njoftimin e palës, me aktin, kur sipas ligjit, nuk lejohet ankesa; 1.3. njoftimin e palës me aktin, kur, sipas ligjit, ankesa nuk ka efekt pezullues 1.4. njoftimin e palës me aktin e ndalimit të efektit pezullues të ankesës, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 130 të këtij Ligji, apo 1.5. njoftimin e palës për refuzimin e ankesës”, rrjedhimisht në rastin konkret Komuna e Lipjanit me rastin e largimit të ankuesit nga lista e pagave nga muaji gusht ka vepruar në pajtim me ligjin dhe dispozitat e lartë cekura sepse akti administrativ është bërë i ekzekutueshëm për shkak se ankuesi nuk e ka kundërshtuar me ankesë, mbi këtë bazë pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara sepse në momentin e dorëheqjes së dhënë nga ankuesi i njëjti e ka humbur statusin e nëpunësit civil.

Andaj, meqenëse ankuesi nuk e ka statusin e nëpunësit civil, Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi që të shpallë veten jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1404/2023 të datës 13.11.2023 të parashtruar nga ankuesi Valzim Mziu.

Theksuar si më sipër e në zbatim të dispozitave të nenit 88 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.1404/2023**

**Kaltrina Avdullahi-Prenaj**

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Avokati;
- Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.